

D E K R E T
Nr.753, datë 13.1.1994

**PËR PËRJASHTIMIN NGA TAKSA DOGANORE TË MALLRAVE TË IMPORTUARA NË
KUADRIN E PROJEKTEVE ME KREDI ME KUSHTE LEHTËSUESE**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,,

D E K R E T O J

Neni 1

Në nenin 3 të ligjit nr.7675, datë 2.3.1993 , “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 “Për tarifat doganore”, shtohet shkronja “j” me këtë përmbajtje: “Për të gjitha mallrat që importohen në kuadrin e projekteve të kredive me kushte lehtësuese me Bankën Botërore (International Development Association IDA), IFAD, Banka Islamike e Zhvillimit dhe organizma të tjera ndërkombëtare”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

Sali Berisha